

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Teuta Spahiu, procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarës V. K., nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.3686/15 të datës 11.12.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Besim Susuri, dhe të akuzuarës, me date 28.06.2016 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara:

V. K., nga i ati S., e ëma E., e lindur B., i lindur me dt. *data e lindjes...*, fshatin S., Komuna e Suharekës, tani jeton në Prizren, Rr.... nr..., Nr. letërnjoftimit *numri personal...*, ka të kryer shkollën fillore, amvise, e martuar, nënë e tre fëmijëve, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

Se prej datës së pavërtetuar e deri më dt. 13.02.2015, në Prizren, pikërisht në shtëpinë e tij, përfiton nga shërbimi komunal përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes pa autorizim të shfrytëzuesit të autorizuar, në atë mënyrë që ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë direkte nga kabli furnizues ka bërë degëzim jashtë matjes, anashkalim njehsorit, ashtu që energjia elektrike e shpenzuar nuk regjistrohet me ç'rast ndërmarrjes së dëmtuar "KEDS", Departamenti ligjor në Prizren i ka shkaktuar dëm material në shumë prej 143,92 €.

Këso dore ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës .

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 7, 41, 43 al.1 pika 1.3, 46, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 51 par.4 52, 73, 74, 75 dhe 76 të KP-ës, te akuzuarës i shqipton:

DENIM ME KUSHT

Ashtu qe i vërteton dënimin me burg ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse e akuzuara nuk kryen vepër te re penale, dhe

Dënimin me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) Euro, i cili dënim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse e akuzuara nuk kryen vepër te re penale,

E dëmtuara: KEDS, Distrikti në Prizren, për realizimin e kërkesës pronësore juridike udhëzohen në kontestin e rregullt civil.

Obligohet e akuzuara qe të paguaj shpenzimet në emër të paushallit gjyqësore shumen prej 20,00 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.3686/15 të datës 11.12.2015 kundër të akuzuarës V. K., nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës

Prokurori i shtetit Musli Gashi, në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: qëndroj në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.3490/2015 të datës 30.11.2015, kundër të akuzuarit A. K., nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-së, dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, duke u bazuar në dispozitat e KP, meqenëse këtu i akuzuari në shqyrtimin fillestar në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale si në aktakuzë, i propozoj gjykatës që ti merr parasysh të gjitha rrethanat cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese ti merr parasysh pranimi i fajësisë nga i akuzuari në mënyrë vullnetare për veprën penale e cila i vihet në barë,

I akuzuari A. K., në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: e pranoj veprën penale cila më vihet në barë, viteve 90-ta, kam qenë i pushuar nga puna nga ana e organeve të masave të dhunshme të atëhershme, dhe se kam qenë pa të ardhura mujore personale, andaj nuk kam pasur mundësi që të bëjë pagesën e energjisë elektrike. Disa shokë dhe miq më kanë mundësuar të bëjë shfrytëzimin e energjisë elektrike në mënyrë siç është përshkruar në aktakuzë, ngase unë personalisht nuk merrem vesh në njehsor e aq më pak në energji elektrike. Andaj duke pasur parasysh që njehsori i cekur është në emrin tim, e pranoj edhe veprën penale e cila më vihet në barë, por i propozoj gjykatës që të gjitha të cekurat më lart, që kjo është hera e parë që kam ra në konflikt me ligjin, që jam person familjar, baba i dy fëmijëve, dhe premtimin tim që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm, të gjitha këto rrethanat i propozoj gjykatës që ti merr si rrethanat lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se prej datës së pavërtetuar e deri më dt. 13.02.2015, në Prizren, pikërisht në shtëpinë e tij, përfiton nga shërbimi komunal përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes pa autorizim të shfrytëzuesit të autorizuar, në atë mënyrë që ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë direkte nga kablli furnizues ka bërë degëzim jashtë matjes, anashkalim njehsorit, ashtu që energjia elektrike e shpenzuar nuk regjistrohet me ç'rast ndërmarrjes së dëmtuar "KEDS", Departamenti ligjor në Prizren i ka shkaktuar dëm material në shumë prej 143,92 €.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarës, e cila në shqyrtimin gjyqësor vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak të cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se e akuzuara ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale të cilat janë

paraqitur në aktakuzë, për të cilat e akuzuara ka qenë e njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarës është bërë në pajtim me neni 248 të KPP-ës dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarës formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës .

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarës gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-ës të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarës, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, konform neni 74 gjykata mori si rrethanë lehtësuese rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtës, bashkëpunimin e përgjithshëm të personit të gjykuar në gjykatën, bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin dhe ndjekjen penale, pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e personit të dënuar, mosha e të akuzuarës në momentin e kryerjes së veprës penale, sjellja e saj pas konfliktit, është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, më herët nuk ka qenë e dënuar, çka do të thotë se nuk ka ra ndeshë me rregullat pozitive, është person familjar, e ve, nënë e tre fëmijëve, si dhe është shfrytëzuese e beneficioneve të veteranëve të luftës, në bazë të vërtetimit të Organizata e veteranëve të luftës, të datës 29.01.2016, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti, nuk kryen vepër të re penale, si dhe dënimin me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti, nuk kryen vepër të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së saj dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më e kujdesshme dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPK-ës.

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.2118/15 me datë 28.06.2016

Procesmbajtësja
Teuta Spahiu

Gjyqtari
Luan Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.